



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 1693 Prot.

Vau Dejes me 21.03.2024

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për Funksonimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Plezhë (të pajisur me dokument identifikimi), Njesia Administrative Bushat dhe Vau Dejës të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimet e mëposhtëme:

Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurrimit të sipërfaqes prej 20 ha, pjesë e pasurisë nr.148, Zk nr.2993 e llojit “ Kullotë “, në fshatin Plezhë, Nj.Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës “Për ndërtim parku fotovoltaiak, aerogjeneratorë(stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)

(Paraqitur nga Drejtoria e Prokurimeve dhe Integritit Sektori Aseteve.)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **25.04.2023 ora 10.00** fshati Plezhë.

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjesës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al, facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI I KËSHILLIT

Ardian CELEPIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETERVE
SEKTORI I ASETERVE

Projekt – Vendim

Nr 02 Datë 06.03 2024

“Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit, të sipërfaqes prej 20 Ha, pjesë e pasurisë nr 148, Zk nr 2993, e llojit “Kullotë”, në fshatin Pleshë, Nj Ad Bushat, Bashkia Vau Dejës. “Për ndërtim parku fotovoltai, aerogjeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj).

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 3, neni 27 pika 5, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.01.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 246, datë 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr 68, datë 28.01.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, Çertifikatën e pronësisë për pasurinë nr 148, me Kod Unik 2045780, VKM nr 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.”, Udhëzimin nr 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

VENDOSI :

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit, me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 20 Ha, e llojit “Kullotë”, pjesë e pasurisë nr 148, Zk nr 2993, fshati Pleshë NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës, sipas plan rilevimit bashkëlidhur.
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.
3. Vlera dysheme e qirasë vjetore, të jetë sipas pikës 8/4, shtojca nr 1, të VKM-së Nr 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.
4. Pas miratimit në Këshillin Bashkiak, dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e prefektit të Qarkut Shkodër, do bëhet shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike, dhe vazhdimi i procedurës së konkurimit publik me të gjithë elementët e saj përbërës deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

HARTUESIT E PROJEKT VENDIMIT
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETEVE
Sektori Aseteve

Konceptoi: Sp/sek Aseteve Denada Dodaj

Miratoi: P/sek Aseteve Ndoc Baqli



KRYETARI

Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Gjovalin Zefi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETIVE
SEKTORI ASETIVE

RELACION

Dhënie në përdorim me kontratë qiraje të pasurisë së llojit “Kullotë”, “Për park fotovoltajk”, aerogjeneratorë (stacionet,objektet përkatëse etj).

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i pronave shtetërore, ku bëjnë pjesë edhe ato të llojit kullotë, në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin nr 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ku në piken 5 të këtij neni përcaktohet: Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, janë të rëndësishme dhe bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”,neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika el, neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë. Procedurat e mëtejshme do ndiqen sipas Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika 7.

Sipërfaqja që propozohet për tu dhënë në përdorim, do kalojë nëpërmjet procedurës së prokurimit publik, me të gjithë elementët e saj përbërës, sipas legjislacionit në fuqi.

Sipërfaqja që kërkohet të merret në përdorim është 20 Ha.

Kjo sipërfaqe e propozuar për tu dhënë në përdorim është në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, me çertifikatë pronësie me nr 2045780, në kategorinë e llojit “Kullotë”, për të cilat, rregullimi i afateve dhe tarifave dysHEME për fillimin e konkurimit, do bëhet sipas VKM-së nr. **559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor/kullosor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”,Shtojca 1, pika 8/4, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit **si më poshtë.**

8. Për ndërtim teleferik pasagjeresh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike, (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.).				
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqia e përdorur në Ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit	
			1 vit	2- 5 vjet
1	Kullote	192.000	184.000	176.000

Në total çmimi dysheme i llogaritur është = 3 520 000 lekë në vit.

Për sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me anë të konkurimit, të sipërfaqes prej 20 ha, “Për park fotovoltaike”, (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj).

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Hartuesit e Relacionit

Ndoci Baqli



Denada Dodaj



Arjeta Garubi



KRYETARI

Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Gjovalin Zefi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 2045780
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.VR.P.P. SHKODËR Zona Kadastrale Nr. 2993
 Numri i Pasurisë 148/1 Volumi 3 Faqe 223
 Adresa e Pasurisë PLEZHE
 Lloji i Pasurisë KULLOTE
 Sipërfaqja Totale 571651.00 m2
 Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
 Nqs pallat: Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>BASHKIA</u>	<u>-</u>	<u>VAU DEJES</u>	<u>1/1</u>	<u>SHKODËR</u>

- është pronar i _____ pasurisë me numër 148/1
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V _____ , L _____ , J _____ , P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 1/2/2019 Nr. 1281

Data e lëshimit të çertifikatës
13/5/2020

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
ILIR DIBRA

PLAN RILEVIMI

PERGATITI

HAMID ÇULIQ

Liçensa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e pergatitjes. 11.03.2024

SIPERFAQE

S=200 000 m²

S1 = 108 480 m²

S2 = 20 520 m²

S3 = 71 000 m²

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2993

NR PASURISE 148/1 VOL FAQE


SHKALLA 1:2500

INDEKSI I HARTES : K - 34-76 -(19 -A)

ADRESA E PASURISE

RRETHI: SHKODER FSHATI: PLEZHE

PRONARI/ET: BASHKIA VAU DEJES



ZHE

